

UDHËZIM

“PËR KUSHTET, KRITERET E PËRPUNIMIT DHE KOHËN E MBAJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.60/2016”

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 16 dhe të pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Komisioneri),

UDHËZON:

Ky udhëzim përcakton kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale prej Njësive përgjegjëse të çdo autoriteti publik dhe subjekti privat si dhe ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo autoritet publik dhe subjekt privat në të cilët caktohet një njësi përgjegjëse, në zbatim të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe ILDKPKI, janë kontrollues sepse mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale.
2. Çdo subjekt i të dhënave personale i përfshirë në sinjalizim apo çdo palë pjesëmarrëse në procesin e hetimit administrativ, gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale për çdo përpunim të pretenduar se është kryer në mënyrë të paligjshme.
3. Në çdo rast, kur njësitë përgjegjëse përpunojnë të dhëna sensitive për interes të rëndësishëm publik, përpara bërjes publike të informacionit, kontrolluesit në kuptim të këtij udhëzimi duhet të kërkojnë autorizimin e Komisionerit sipas nenit 7/2/c të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Kontrolluesit përpara përpunimit të të dhënave personale nga njësitë përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 60/2016, plotësojnë dhe depozitojnë pranë Zyrës së Komisionerit njoftimin ose bëjnë përditësimin e tij, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me atë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU II
MASAT E SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI

6. Kontrolluesit përcaktojnë në rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e sigurisë së tyre, masa organizative dhe teknike të përshtatshme me natyrën e përpunimit të të dhënave personale, të cilat duhen marrë dhe zbatuar nga njësitë përgjegjëse.

7. Përpunimi i të dhënave personale bëhet veçanërisht në përputhje me këto masa sigurie:

- a) Aksesit në të dhënat personale duhet të ushtrohet vetëm nga persona të autorizuar dhe për atë që është e lejuar në autorizim;
 - b) Çdo veprim i kryer me të dhënat personale nga persona të autorizuar duhet të dokumentohet;
 - c) Çdo veprim i kryer për të transmetuar të dhënat personale në organe të tjera duhet të jetë i dokumentuar dhe i gjurmueshëm;
 - ç) Ndalohet kopjimi, modifikimi, korigjimi, fshirja dhe çdo veprim tjetër i paautorizuar me të dhënat personale gjatë transmetimit të tyre në sisteme ose gjatë transportimit të dosjeve përkatëse;
 - d) Mosfunksionimi i sistemeve në rastet e përpunimit të të dhënave, duhet të jetë i raportuar dhe të dhënat duhet të ruhen dhe të mos çënohen.
- dh) Për kontrolluesit rekomandohet çertifikimi i sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Punonjësit në njësitë përgjegjëse dhe në ILDKPKI, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit për të ruajtur konfidencialitetin dhe besueshmërinë e informacionit me të cilin njihen edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Shkelja e detyrimit të konfidencialitetit përbën veprë penale të parashikuar nga neni 122 dhe 123 të Kodi Penal.

9. Për përpunimin e të dhënave personale në mënyrë manuale, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- a) Të gjitha dokumentet e përpunuara në mënyrë manuale ruhen të sigurt në mënyrë që të parandalohet përhapja e të dhënave personale, shkatërrimi, humbja e paligjshme, si në vendin e punës ashtu edhe gjatë transmetimit të tyre;
- b) Vënia në dispozicion e kopjeve të kërkuara, mund të kryhet me kusht që të jetë i mundur gjurmimi i përdorimit të tyre të mëtejshëm deri në shkatërrimin ose anonimizimin e tyre.

10. Njësitë përgjegjëse dhe ILDKPKI në përmbushje të ligjit nr. 60/2016, në çdo rast zbatojnë edhe udhëzimet e Komisionerit nr. 21 datë 24.09.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj” i ndryshuar.

KREU III
AFATI I MBAJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

11. Të dhënat personale në dokumentacion mbahen për një periudhë 60 ditë që i korrespondon marrjes së vendimit të përfundimit të hetimit administrativ.

12. Të dhënat personale në dokumentacion fshihen menjëherë pas marrjes së vendimit për mosfillimin e hetimit administrativ.

13. Ndryshe nga se parashikohet në pikën 11 dhe 12 të këtij udhëzimi, kontrolluesi mund të rivlerësojë vetëm një herë kohën e mbajtjes së të dhënave dhe njëkohësisht për këtë njofton subjektin e të dhënave apo palët në proces. Çdo shtyrje në afat për mbajtjen e të dhënave duhet të jetë e arsyetuar.

14. Pas përfundimit të periudhës së mbajtjes së të dhënave, subjekti i të dhënave bëhet i pa identifikueshëm nga të gjithë sistemet aktive të përpunimit të të dhënave, automatik apo manual.

15. Me mbarimin e periudhës së mbajtjes, dokumentet të cilat nuk administrojnë të dhëna personale, arkivohen në rast se ekziston një detyrim i tillë ligjor, ndërsa dokumentet që administrojnë të dhëna personale:

- i. shkatërrohen fizikisht; ose
- ii. bëhen anonime në mënyrë të pakthyeshme.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

16. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi është objekt i sanksioneve të ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen kontrolluesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datë 7.09.2016

KOMISIONERI

Besnik DERVISHI

RELACION
PËR
PROJEKTUDHËZIMIN

“PËR KUSHTET, KRITERET E PËRPUNIMIT DHE KOHËN E MBAJTJES SË TË
DHËNAVE PERSONALE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.60/2016”

Lufta kundër korrupsionit përbën një ndër sfidat kryesore të shtetit dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht dhe prioritetet në hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit dhe Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit. Nga ana tjetër, krijimi i mekanizmave ligjorë në luftën ndaj korrupsionit dhe parandalimi efektiv i tij parashikohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2017, miratuar me vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim dhe në përgjigje të këtyre detyrimeve, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Ligji bëhet për herë të parë pjesë e korpusit të ligjeve në Shqipëri dhe trajton për herë të parë përveç mekanizmave ligjorë dhe proceduralë edhe aspektin e mbrojtjes së të dhënave personale si në përmbajtjen e tij ashtu edhe zbatimin në praktikë. Të dhënat personale të individëve përbëjnë një kategori të pashmangshme në zbatimin e këtij ligji dhe për pasojë edhe Ligjvënësi i ka kushtuar nene të posaçme mbrojtjes së tyre.

Në zbatim të nenit 16, pika 3 dhe nenit 24 pika 3 të ligjit nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”:

Neni 16 i ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;

“1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të këtij ligji. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton me udhëzim të veçantë kushtet dhe kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, sipas këtij ligji”;

neni 24 i ligjit nr.60/2016, si dispozitë me natyrë deleguese për nxjerrjen e akteve nënligjore, parashikon se:

“3. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 16, të këtij ligji”;

në përputhje me ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, është përgatitur edhe Projektudhëzimi “Për kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale në zbatim të ligjit nr.60/2016”.

Projektudhëzimi është hartuar nga Zyra e Komisionerit me kontributin e Partners Albania for Change and Development.

Projektudhëzimi ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe kriteret që duhen zbatuar gjatë përpunimit të të dhënave nga njësitë përgjegjëse të caktuara pranë autoriteteve publike, subjekteve private dhe ILDKPKI të cilët janë kontrollues në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Projektudhëzimi prek çështje thelbësore të përpunimit të të dhënave personale sipas kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, për të pasur në çdo proces hetimor përpunim të drejtë e të ligjshëm të të dhënave pa cënuar privatësinë e subjektit të të dhënave personale.

Nëpërmjet këtij p/akti nënligjor rregullohet veprimtaria e të gjithë palëve pjesëmarrëse në procesin e sinjalizimit lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Projektudhëzimi në Kreun e parë të tij, përcakton “*kontrolluesit*” në kuptim të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar, për shkak të rolit dhe veprimtarisë që kanë në zbatimin e ligjit nr.60/2016, njeh të drejtat e subjekteve të të dhënave personale gjatë përpunimit të të dhënave nga kontrolluesit, parashikon disa prej detyrimeve më të rëndësishme të kontrolluesve, konkretisht bërjen e njoftimit apo përditësimit të tij pranë Zyrës së Komisionerit, përpara se të nisë përpunimi i të dhënave në procesin për trajtimin e sinjalizimit si dhe kërkon depozitim të kërkesës për autorizim pranë Komisionerit për të gjithë rastet kur njësitë përgjegjëse pranë kontrolluesit vlerëson bërjen publike, thënë ndryshe, përhapjen e të dhënave sensitive për interes të rëndësishëm publik. Përmbushja e këtyre detyrimeve parashikohet në këtë projektakt, në kuadrin e marrjes së masave të duhura ligjore, por njëkohësisht lejon Komisionerin të ushtrojë kompetencat e tij monitoruese dhe ndëshkuese në rast të shkeljeve të konstatuara.

Projektudhëzimi në Kreun e dytë të tij, qartëson nevojën e hartimit dhe miratimit të rregullave të shkruara për sigurinë e të dhënave personale në rastet kur të dhënat përpunohen në sisteme elektronike por edhe manuale. Dokumentimi i veprimeve me të dhënat personale edhe për faktin se gjatë përpunimit të të dhënave do të ketë transmetim të tyre në institucione të ndryshme, është faktor i rëndësishëm në zbatimin e drejtë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për këtë arsye ai specifikohet në

këtë akt nënligjor.

Projektudhëzimi në Kreun e tretë të tij, detajon njërin prej veprimeve më të rëndësishme që përmyll procesin e përpunimit të drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale, atë të kohës së mbajtjes/ruajtjes së tyre. Në këtë kre janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në ligjin nr.60/2016 përse i përket afatit kohor të nevojshëm për të kryer një hetim administrativ, çka nënkupton që ky është edhe afati i lejuar për mbajtjen e të dhënave personale dhe më tej procesi duhet të vijojë me shkatërrimin e tyre në formën dhe mënyrën e parashikuar në këtë udhëzim.

Gjithashtu, në këtë kre është parashikuar edhe lejimi i kontrolluesit për të rivlerësuar shtyrje të afateve kohore, por vetëm pas një argumentimi ligjor, pasi çdo veprim ndryshe do të binte në kundërshtim me legjilsacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërsa në kreun e fundit të projektaktit, bëhen referencat ligjore për dënimet administrative në rast të shkeljeve të konstatuara si dhe përcaktohet rrethi i zbatuesve të këtij projektudhëzimi.

Miratimi i këtij projektudhëzimi nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

KOMISIONERI

Besnik DERVISHI